



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES  
PËR MIRATIMIN E LEJES SËNDËRTIMIT PËR:

UZINËN E PRODHIMIT TË FERROKROMIT NË TERRITORIN E  
"REFRAKTARE" SH.A, FSHATI BALLDRE, KOMUNA PAPER, ELBASAN

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T.

Z. EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Z. DAMIAN GJIKNURI

Ministër i Energjisë dhe Industrisë



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, Datë 03.12.2014

Projektues: Ark. Altin PREMTI

Liq. Nr. A.0762/1

ARK. ALTIN PREMTI

LIC. A-0762/1

## TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1. Dispozita të Përgjithshme
  - 1.1 Baza Ligjore
  - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
  - 1.3 Përkufizimi i termave të përdorur
2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
  - 2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
  - 2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit
  - 2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
  - 3.1 Informacion për topografinë e zonës.
  - 3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tillë)
  - 3.3 Informacionmbizonatëmbrojturanatyroredheatotëtrashëgimisëkulturoredhehistorik e
  - 3.4 Informacion mbi infrastrukturën eksistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj
  - 3.5 Përbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
  - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave
  - 4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa
  - 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
  - 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë
  - 4.5 Rregullat e zhvillimit
  - 4.6 Vendqëndrimi për automjetet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
  - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
    - 5.1.1 Rrjeti Rrugor
    - 5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike
    - 5.1.3 Impanti i mbrojtjes kundra zjarrit
    - 5.1.4 Impanti i shkarkimit të ujrale të zeza
    - 5.1.5 Impanti i furnizimit me ujë
    - 5.1.6 Impanti i shkarkimit të ujrale të shiut
  - 5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë
6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit
7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.
8. Impaktet Kryesore në Mjedis
  - 8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës

- 8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore
- 8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore
- 8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)
- 8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve
- 8.6 Impakt mbi Peizazhin
- 8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin
- 8.8 Impakt mbi trashëgiminë kultutore dhe arkeologjинë

9. Anekse (Hartat në format A3)

## **1. Dispozita të Përgjithshme**

### **1.1. Baza Ligjore**

- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

#### **Për koncesionin**

- Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet"
- Ligji nr.9995, datë 22.09.2008 "Për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9663"

#### **Per mjedisin**

- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Mbi lejet mjedisore"
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 " Mbi mbrojtjen mjedisore"
- Ligji nr.10440, datë 07.07.2011 "Mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor"
- Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Mbi manaxhimin e mbetjeve të integruara"
- Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 " Për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr. 9868, datë 04.02.2008 " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 06.06.2002 " Për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr.9983, datë 08.09.2008 " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8934 datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit, i ndryshuar"
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 " Për mbrojtjen e faunës së eger"
- Ligji nr.9587, datë 20.07.2006 " Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji nr. 111/2012 " Për manaxhimin e integruar të burimeve ujore"

#### **VKM**

- Vendim i KM nr. dt. 04.01.2013 " Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedures së vlerësimit të ndikimit në mjedis.

#### **Udhëzimet**

- Udhëzim nr.3, datë 02.12.2013 "Për VNM dhe lejet e Mjedisit"
- Udhëzim nr.6, datë 27.12.2006 " Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në Mjedis".

### **1.2 Përvetësime**

Zona në studim është pjesë e Komunës Paper. Komuna Paper është një komunë e rëndësishme në rrethin e Elbasanit. Rajoni i Elbasanit është një nga 12 rajonet e Shqipërisë, me një sipërfaqe prej 3.278 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 433.244 banorë. Malet rrëtjojnë komunën në Veri / Lindje, Lindje dhe Jug / Lindje. Kodrat janë të vendosura në Veri / Perëndim, Perëndim dhe Jug / Perëndimit të Komunës.

Fushat janë vendosur në qendrën e Komunës.Komuna Paper është e vendosur në afersi të Elbasanit, në jug/perëndim të tij. Territori i Paperit përbëhet pothuajse nga terren i sheshtë.



fig 1- Harta e lidhjes së parcelës për ndërtim, me qendrën e qytetit

Zona ku do të zhvillohet parcela ndodhet në fashtin Balldre, Komuna Paper, Elbasan. Parcela në studim është pozicionuar në pjesën perëndimore të qytetit, në një zonë industriale e cila është formuar kryesisht nga uzina dhe fabrika ekzistuese, lehtësisht e aksesueshme nga rruga nacionale.

Parcela ku do të zhvillohet Uzina e Ferrokromit, ndodhet në pronësi të "Refraktare" SH.A me një sipërfaqe trualli  $61\,600\text{ m}^2$ , marrë me qera nga "GSA" Sh.P.K, ku pjesërisht është e zënë nga struktura ekzistuese.

Parcela kufizohet në:

- Veri - Perëndim nga "Refraktare" SH.A dhe El - Tub SH.P.K.
- Veri - Lindje nga "Refraktare" SH.A
- Jug - Lindje nga hekurudhë ekzistuese
- Jug - Perëndim nga rrugë ekzistuese e fshatit Balldre.

### 1.3. Përkufizimi i termave të përdorur

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**"Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të"** - për një nën-njësi të caktuar, vlerësohen kategoritë e zhvillimeve të lejuara në atë nën-njësi sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në përputhje me Planin e Përgjithshëm.

**"Strukturë"** është çdo objekt i ndërtuar ose i instaluar në territor, që ka vendosje të palëvizshme osc të përkohshme dhe, sipas rastit, përfshin tokën në, mbi dhe nën të cilën ndodhet struktura.

**"Zhvillimi"** Kryerja e çdo punimi mbi ose nën tokë, ose kryerja e çdo veprimi ndarje apo bashkim parcele, modifikimi në përdorimin e tokës, si dhe ndërtimet në të.

**"Përdorim publik"** Sipërfaqe totale e tokës së zonave në zhvillim, e cila është planifikuar për:

**"Blok ndërtimi"** Një zonë që rrrethohet nga rrugë ose hapësira të tjera të hapura publike; ajo mund të përbajë një ose më shumë parcela.

**"EN"** - Standarte Europiane të materialeve dhe kushteve të projektimit (European Norms).

## **2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT):**

Nga verifikimet e kryera, si dhe referuar faqes zyrtare të AKPT [www.planifikimi.gov.al](http://www.planifikimi.gov.al) Komuna Papër nuk ka një Instrument Planifikimi të miratuar.

### **2.1. Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV**

Zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, si rrjedhim nuk ka orientime dhe detyrime, të cilave ky zhvillim duhet ti përbahet.

### **2.2. Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit**

Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka rregulla, norma dhe standarte zhvillimi, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

### **2.3. Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim**


Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka harta, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

## **3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)**

### **3.1 Informacion për topografinë e zonës.**

Sheshi i ndërtimit ndodhet në një zonë me një pjerrësi të lehtë, pothuajse të pa përfillshme, me drejtim jug-veri, ku sipërfaqja e sheshit është pothuajse e rrafshët me ndërtime ekzistuese.

Parcela pothuajse e vendosur në një terren të rrafshët, është e formuar me ndërtime ekzistuese, të cilat do të funksionojnë së bashku me ato të propozuarat.



-fig 2- Rilevimi topografik

### 3.2. Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)

Për këtë zonë nuk janë parashikuar apo evindentuar zona si burime natyrore dhe mjedise pyjore. E gjithë zona është e formuar me godina me karakter industrial, fabrika dhe uzina që perdoren për veprimtari industriale, si psh: impianti i Ferrokromit, Fabrika e profileve metalike, etj.

### 3.3. Informacion mbi zonat e mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore edhe historike

Zona ku do të zhvillohet ndërtimi, është një zonë e formuar dhe në gjithë historikun e saj ka qenë një zonë industriale. Uzina e prodhimit të Ferrokromit do te zhvillohet ne territorin e "Refraktare" Sh.A, territor, rrëth të cilin ndodhen fabrika dhe uzina ekzistuese. Zona për zhvillim nuk ka objekte me status "monument kulture", "zonë historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur".

### **3.4. Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj**



*-fig 3- Infrastruktura ekzistuese e zonës*

Infrastruktura rrugore është e formuar. Parccla ndodhet lehtësish e aksesueshme nga rruga nationale Elbasan -Durrës. Objektet propozohen të zhvillohen në një parcelë të formuar me infrastrukturë ekzistuese, e cila ristrukturohet dhe adaptohet në funksion të strukturave të propozuara dhe atyre ekzistuese. Infrastruktura ekzistuese shtrihet deri në parcellen që do të zhvillohet, duke e bere më të aksesueshme dhe duke krijuar lehtësira në zhvillimin e godinave të propozuara duke iu bashkangjitur atyre ekzistuese.Qarkullimi për në parcelë do te behet sipas pozicionit që diktojne vete godinat, duke ndjekur sistemin e brendshem rrugor ku pervec infrastrukturës ekzistuese plotesohet dhe me rrugë të reja.

Përgjithësisht zona nuk ka mungesa të burimeve të ujit, kryesisht si zonë që shtrihet paralel me lumin Shkumbin.Furnizimi me ujë bëhet nga Ndërmarrja e Ujësjellesit Elbasan, nga tubi ekzistues, furnizues i fshatit Balldre.

Vetëm fshatrat Balldre, Lugal dhe Ullishte janë të pajisur me rrjetë të ujrate të zeza. Fshatrat e tjerë janë duke përdorur "gropa septike". Një pjesë e mirë e rrjedhjeve shkon në nivelet baze të tokave dhe ujërate. Mbetjet mblidhen nga shërbimet private të angazhuar për këto aktivitete. Ujërat e zeza të mbledhura nga rrjeti i ujërate të zeza, ose nga autobote shkarkohen në vende të përcaktuara nga ana e komunës, por nuk trajtohen. Gjendja e furnizimit me energji elektrike nuk është problematike. Zona furnizohet nga rrjeti ekzistues, Linja 110 KV Elbasan, Linja 110 KV Cërrrik dhe shpërndahet me linjën kabllore 10 KV.

### **3.5. Përbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistues**

- Zonë fushore me ndërtimë industriale
- Përdorimi aktual truall me ndërtesa përkatese me karakter industrial
- Infrastruktura e zonës është funksionale, me sistem rrugor të aksesueshem, rrjet kanalizimesh dhe rrjet furnizimi me energji elektrike ekzistues.

## **4 .Rregullat e Zhvillimit të Territorit**

### **4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave**

Të gjitha zhvillimet në territor janë në përputhje me kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës.

Kategoria e përdorimit të tokës hyn në kategorinë: përdorimi Industri, I "Industri" Sipërfaqja totale e parcelës prej 61 600 m<sup>2</sup> është e përshtirë nën kategorinë e sipër përmendur. Përdorimi i strukturës së re është tërësisht me funksion si uzinë prodhimi Ferrokromi me sipërfaqe totale ndërtimi 13 268 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe gjurme 7 405 m<sup>2</sup>.

Parcela që do të zhvillohet do të përbajë godinat e poshtë shënuara sipas renditjes, bashkë me funksionet përkatëse:

G01 - Reparti i shkrirjes dhe i derdhjes

G02 - Reparti i lendëve të para si dhe vendi i depozitimit të mineralit të kromit dhe depozitimit të koksit

G03-Reparti Mekanik

G04-Godina Multifunksionale dhe Reparti i thyerjes së FeCr

G05-Stacioni i pompave, pishina e skorjes dhe granulimit të skorjes,

G06-Stacioni i pompave dhe freskoret

a-stacioni i pompave

b-feskoret

G07-Sistemi i pluhurkapjes

G08-Godina e peshores

G10- Dhoma e rojes

### **4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa**

Sipërfaqe e zënë nga struktura të propozuara ( gjurma ):7 405 m<sup>2</sup>.

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nga struktura të propozuara: 13 268 m<sup>2</sup>.

Sipërfaqe e zënë nga struktura ekzistuese : 10 804 m<sup>2</sup>.

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nga struktura ekzistuese: 11 864 m<sup>2</sup>.

Koeficjenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim 29.5%.

Intensiteti i ndërtimit: 0.40

Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:34.66 m.

#### **4.3 Pamja e jashtme e godinave/Trajtimi i fasadave/Trajtimi i mbulesave**

Zona që zhillohet është një zonë industriale dhe strukturat që do të zhillohen në këtë zonë do të respektojnë gjuhën e godinave industriale me materiale të lehta, konstruksion miks (beton arme dhe metalik), me soleta monolite dhe çati me konstruksion e kapriatë metalike. Këto objekte do të plotësojnë përsazhin industrial të zonës dhe përmirsimin e këtij imazhi në kuadër të zhvillimeve të reja që do të sjellë.



*-fig 4- Perspektivë e Uzinës së Prodhimit të Ferrokromit*

Arkitektura është e thjeshtë dhe respekton linjat e pastra gjemometrike dhe kuadratike në strukturat e zhvilluara. Duke qenë një objekt industrial respektohen normat për sipërfaqet e hapura të xhamit, normat për hyrje-daljet dhe qarkullimin e njerëzve, automjetetve edhe mallrave, ngjyrat që duhet të përdoren, materialet që duhet te perdoren, lartesite e ambjenteve etj. Nga projektimi mbi bazat e normativave per këto tipe godinash, përfshojmë volume të ndryshme, të cilat rrinë në harmoni me njëra-tjetrën dhe lidhen me struktura metalike karakteristikë për këtë lloj arkitekturë.

Materialet që do të përdoren për zhvillimin e godinës, do të janë :

- suva plastike e ngjyrosur ( krem dhe ngjyrë gri) e ndarë me fuga ngjyrëgri të errët
- veshje me llamarinë ngjyrë gri.

#### **4.4 Normat e zhvillimit**

##### **Lartësia e katit**

Lartësia e strukturës jepet në metra dhe në numra katë (k). Lartësia minimale:

- a. lartësia e katit nëntoke, në të cilin ndodhen ambientet teknike, është 3.50m (dyshemë-dysheme)
- b. lartësia e katit përdhe, dhe kateve të tjera janë të larta , për vetë funksionin specifik që vetë ndërtimi ka.

##### **Koefiqientët e shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe hapësira publike**

1. Koefiqienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë, ose  $K_{sh}$ , është raporti midis sipërsaqes së gjurmës që do të zënë rrugët dhe sheshet në zonën e marrë në studim dhe sipërsaqes bruto të saj.
  2. Ksh-ja paraqitet në % për çdo zonë duke vlerësuar:
    - numrin e strukturave sipas përdorimit;
    - distancat midis rrugëve dhe strukturave;
    - nevojën për diellëzim dhe eliminim zhurmash;
    - nevojën për të siguruar hapësirën e nevojshme për kalimin e infrastrukturave nëntokësore dhe ajrore;
    - nevojën për krijimin e lidhjes së çdo strukturë të vetme me rrugë;
  3. Në çdo rast, Ksh-ja c'propozuar është në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi i mugor i Republikës së Shqipërisë".
  4. Koefiqienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike ( $K_{shp}$ ) është raporti i sipërsaqes së gjurmës së strukturave dhe territoreve të hapura për hapësira publike, si gjelbërim, territore sportive, sheshe lojërash etj., në parcelë me sipërsaqen bruto të parcelës.
- Sipërsaqja e shfrytëzuar për hapësira publike është 19 683 m<sup>2</sup> me k.sh.p. 31%.

#### **4.5 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për parcelën**

##### **Kategoria e përdorimit të tokës dhe strukturave në të**

1. Madhësia e zonave me përdorim të kategorisë bazë 1 "Industri" varet nga lloji i industrisë, strukturat dhe territoret që nevojiten për të, si dhe nga rregullat dhe kushtet e përcaktuara në politikat e zhvillimit strategjik dhe të planifikimit territorial të njësisë vendore apo të autoriteteve të qeverisjes qendrore.
2. Zona industriale duhet:
  - a) të lidhet me të gjitha rrugët e trafikut të rëndë të jashtëm dhe të shpejtësisë së lartë;
  - b) të respektojë distancat nga qendrat e banuara në varësi të llojit të aktivitetit dhe treguesve mjedisorë, sipas përcaktimeve të legjisacionit të posaçëm në fuqi;
  - c) të rrethohet me breza mbrojtës sanitare;
  - d) të pozicionohet në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër të mos lëvizin me erën drejt qytetit;
  - e) të ketë një rrjet të infrastrukturave të pavarur nga ai i qendrës dhe i zonës së banuar;

dh) të përbajë edhe zonat dhe zgjidhjet e brendshme për trajimin e mbetjeve të të gjitha llojeve që shkarkohen nga aktiviteti industrial.

#### **Tipologjitet e propozuara të strukturave**

Tipologjia e strukturës në projekt është strukturë me lartësi të lartë.

#### **Lartësia e propozuar e strukturave e shprehur në kate.**

Lartësia maksimale e strukturës është 4 kate.

#### **Koefiqienti i shfrytëzimit të tokës**

Koefiqienti i shfrytezimit të tokës është 29.5% e parcelës.

#### **Intensiteti i ndërtimit**

Intensiteti i ndërtimit është 0.40.

#### **Trajtimi i sipërfaqeve të gjelbra**

Sipërfaqe të gjelbra të tipit kompakt janë 8072 m<sup>2</sup>. Sipërfaqet janë trajtuar me gjelbërim të ulët të tipit bar dhe ligustër.

#### **Vija e ndërtimit**

Objektet e propozuara duhe të respektojnë vijën e ndërtimit të krijuar.

Kategoria e përdorimi të tokës	I "Industri"
Sipërfaqja e parcelës	61 600 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e njollës se propozua	7 405 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e njollës ekzistuese	10 804 m <sup>2</sup>
Koefiqienti i shfrytëzimit të tokës	29.50%
Sipërfaqe rruge	11611m <sup>2</sup>
Koefiqienti i shfrytëzimit për rrugë	18.84%
Sipërfaqe gjelbërimi	8072m <sup>2</sup>
Koefiqienti i shfrytëzimit për rrugë dhe hapësira publike	31%
Siperfaqe per gjithshme ndertimi nga struktura te propozuara	13268m <sup>2</sup>
Siperfaqe per gjithshme ndertimi nga	11864m <sup>2</sup>

struktura ekzistuese	
Intensiteti i ndërtimit	0.40
Numri max.i kateve mbitokë	4K
Numri i kateve nëntokë	1K

*Tabela e treguesve*

#### **4.6 Vendqëndrimi për automjetet / Parkimet**

Parkimet janë vendosur në hapësirën e sheshit të krijuar në brendësi të parcelës, duke shfrytëzuar hapësirat ekzistuese.

#### **5. Rregullat e rrjeteve të infrastrukturës**

##### **5.1 Pozicionimet e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturës**

Shumica e sistemeve të infrastrukturës (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), duhet të vendosen nën sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qëndror infrastrukture, përgjatë rrugëve të reja të parashikuara.

Për sa i përket rrjetit inxhinierik, ku përfshihen:

- sistemimi i ujrave të zeza;
- rrjeti elektrik dhe ai i ndriçimit të rrugës;
- rrjeti i furnizimit me ujë, etj

Duhet të parashikohen të ndërtohen nën zonën e trotuareve.

##### **5.1.1 Rrjeti rrugor**

Rrjeti rrugor adaptohet duke ndërhyrë në atë të propozuarin dhe duke shtuar atë të ri, përgjatë ndërtesave që do të zhvillohen, së bashku me të do të ndërtohen paralelisht rrjetet e kanalizimeve, ujësjellësit dhe elektrik sipas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse.

##### **5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike**

Zona furnizohet nga rrjeti ekzistues, Linja 110 KV Elbasan, Linja 110 KV Cërrik dhe shperndahet me linjen kabllore 10KV, në pikën e lidhjes të së cilës do te ketë në ambjentin e kabinës së godinës ku do të bëhet vendosja e paneleve të tensionit të mesëm për hyrje-dalje të linjës si dhetrasformatori dhe paneli i matjes së energjisë elektrike në tensionin e ulët. Prezenca e këtyre dy burimeve të emergjencës kërkon që rrjeti i shpërndarjes në tensionin e ulët të jetë i përbërë nga 3 rrjete:

Sistemi i shpërndarjes "NORMAL" ku përfshihet furnizimi i pajisjeve, të cilat janë jashtë shërbimit në rast të mungesës së energjisë nga rrjeti.

Sistemi i shpërndarjes "EMERGJENCËS" ku përfshihet furnizimi i pajisjeve nëpërmjet rrjetit normal dhe moto-gjeneratorit. Ky rrjet duhet të sigurojë kthimin e energjisë në jo më pak se 40 sec.

Sistemi i shpërndarjes "UPS" ku përfshihen furnizimi i pajisjeve të cilat në rast mungese energjie nga rrjeti normal furnizohen nga pajisjet UPS. Ky rrjet duhet të sigurojë vazhdimin e furnizimit të pajisjeve për një kohë jo më të vogël se 15 min.

### **5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit**

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në bazë të:

Normave, rregulloreve dhe kriterieve projektuese të vendeve të Komunitetit European si dhe në përputhje me rregulloret MKZSH në Shqipëri.

Për të përdorur agjentë shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit. Në projekt janë përcaktuar me saktësi zonat sipas klasit të zjarrit dhe në përputhje me to janë zgjedhur lloji i fikseve portative (bombolave) si dhe hidratet e zjarrit ose sistemi i automatik i shuarjes së zjarri (sprinklerat).

Implantet e palëvizzëshme të shuarjes së zjarrit:

Hidrante në brendësi të godinës

Lidhjet me autopompën (aplikohen në pozicionet më përshtatëshme për lidhjen e automjeteve të zjarfikëseve)

Pajisjet e lëvizshëme të shuarjes së zjarrit:

Bombola portative (shkumë, pluhur, gaz) aplikohen në përgjithësi në të gjithë godinën.

### **5.1.4 Rrjeti i shkarkimit të ujравë të zeza**

Ky sistem vetëkuptohet shërben për shkarkimin e ujравës të zeza nga ambientet hidrosanitare të godinave. Ai është i përbërë nga rrjeti i brendshëm i ambienteve sanitare, kolonat e shkarkimit, nga kalimet horizontale të tyre në tokë, deri në pusetat primare osc pusetat mbledhëse të kolonave dhe lidhja e tyre me rrjetin të jashtëm në aksin e rrugës dhe shkarkimi i tyre në rrjetin ekzistues të zonës.

Për shkarkimet e ujравës do të përdoren tuba plastike PP (polipropilen i termostabilizuar në temperaturat e larta) që plotësojnë të gjitha kërkësat e cilësisë sipas standartit EN 1451 (Kërkesa për testimin dhe kualitetin tubave). Ata janë dizenuar në përputhje me standartin EN 12056.

Tubat e shkarkimit duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtuesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësish sa më afër atyre nyjeve që mbledhin më shumë ujëra të ndotura dhe ndotje më të mëdha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh në çdo kat me anë të tubave të dërgimit. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Tubat e dërgimit mund të shtrohen anës mureve, mbi ose nën soletë duke mbajtur parasysh kushtet e caktuara për montimin e rrjetit të

brendshëm të kanalizimeve. Gjatësia e këtyre tubave nuk duhet të jetë më tepër se 10 m. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur.

### **5.1.5 Rrjeti i furnizimit me ujë**

Furnizimi i ujit të ftohtë sanitari bëhet nëpërmjet rrjetit të jashtëm nga puseta e kontrollit. Nëpërmjet prurjes dhe presionit që ka rrjeti i jashtëm bëhet furnizimi i rezervave të përgjithëshme të ujit të vendosura në ambientet teknike.

Dimensionimi dhe projektimi i të gjithë komponenteve dhe aksesorëve të sistemit të furnizimit dhe të shpërndarjes të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë sanitari është realizuar duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Skema e shpërndarjes;
- Dimensionimi i rezervuarve të ujit për 48 orë autonomi;
- Përcaktimi i prurjes nominale për çdo aparat h/sanitar dhe dimensionimi i tubove;
- Dimensionimi i tubacioneve magjistrale dhe ato të riqarkullimit;
- Prurja totale nominale;
- Prurja projektuese;
- Presioni i punës;
- Humbjet gjatësore njësi të presionit;
- Shpejtësia max. e qarkullimit të ujit;
- Dimensionimi i stacionit të pompimit (shpejtësi konstante);
- Dimensionimi i autoklavës;
- Dimensionimi i boilerave elektrike.

### **5.1.6 Sistemimi i ujrave të shiut**


Ky sistem shërben për shkarkimin e ujrave të shiut dhe përbëhet nga sistemi i piletave dhe kolonave të mbledhjes së ujrave të tarracave. Ujrat e tarracës nëpërmjet piletave dhe kolonave kalon në pjesët horizontale të tyre, në puscatat mbledhëse për të shkarkuar në rjetin ekzistues të zonës. Po në këtë sistem janë futur edhe drenazhimi i ujrave të bardha.

## **5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë**

Hapësirat e lira synojnë më tepër drejt hapësirave rekreative të pajisura edhe me elementë të mobilimit urban. Sipërfaqja e gjelbërtë e tipit kompakt është  $8072\text{ m}^2$ . Kjo sipërfaqe është me gjelbërim të ulët të tipit bar, ligjstëri përreth bordurave, lule dekorative dhe aromatike në brendësi të sipërfaqes.

## **6. Fazat e zhvillimi të Lejes së Ndërtimit**

Ndërtimi i godinave do të ndjekë fazën e zhvillimit sipas legjendës së paraqitur në figurë. Fazat në vijim (sipas legjendës) do të ndjekin zhvillimin e godinave sipas renditjes në legjendë. Periudha kohore e parashikuar për fillimin dhe përfundimin e punimeve sipas grafikut të punimeve parashikohet rreth 27 muaj.



-fig 5- Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit

Parcela do të përbëhet nga struktura ekzistuese dhe struktura të propozuara. Strukturat e propozuara do të konceptohen në tre faza ndërtimi:

- #### • Godina ekzistuese

G02- Vendj i depozitimit te mineralit te kromit dhe depozitimi i koksit

G03 -Reparti mekanik

G04- Godina Multifunksionale dhe Reparti i Thyerjes së FeCr

- Faza I-të përfshin strukturat:

#### G01 - Reparti i shkrirjes dhe i derdhjes (pjesa e parë)

G02 - Reparti i lēndēye tē para

G05-Stacioni i pompareve, pishina e skories qe granulimit te skories

G-06-Stacioni i pompareve, përmend që shqetësi është gjatë

Geo Staelens i postsp  
a station i Normandie

**a-stavoln-i**

G03. Sistemi i algoritmovi (nizovi o nizi)

*G07-Sistemul I printrui cap*

G08-Doula e peso  
G18-Plano e peso

- Faza II-të përfshin strukturat:  
G01 - Reparti i shkrirjes dhe i derdhjes (pjesa e dytë)  
G07-Sistemi i pluhurkapjes (pjesa e dytë)
- Faza III-të përfshin zgjerim e Repartit të shkrirjes dhe të derdhjes(G01), si dhe shtim të sistemit të pluhurkapjes (G07).

## **7 . Relacioni i menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.**

Për ndërtimin e strukturës së objekteve që propozohen nevojitet kryerja e punimeve të gërmimit në mënyrë për të realizuar gërmimin që duhet për themelet,të cilat janë menduar të zgjidhem me pilota me jastik të lidhur.

Volumi i dherave i parashikuar që do të dalë nga gërmimi dhe nga kryerja e punimeve do të depozitohet në vend grumbullimin e përcaktuar nga Komuna.

## **8. Impaktet Kryesore në Mjedis**

### **8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës**

Vendi, objektet dhe infrastruktura inxhinierike ku realizohen ndryshimet e propozuara është përdorur për qëllime industriale që në vitet '80. Edhe tani kjo infrastrukturë është përdorur për të njëjtat qëllime prodhimi.

### **8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore**

Aktivitetet e ndërtimit/montimit mund të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësorë nga rrjedhja (humbjet) ose derdhjet aksidentale të lëndëve djegëse, vajrave, substancave kimike të ndryshme, etj.

Për të shmangur/minimizuar ndotjen, materialet e lartpërmendur, do të depozitojen në sheshe depozitimi të posaçme; procedurat e punimeve do të sigurojnë që këto materiale të përpunohen në mënyrë korrekte.

### **8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore**

Objekti që do të zhvillohet nuk ka impakt mbi ujrat nëntokësor.

## **8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)**

### **8.4.1. Flora dhe Fauna**

Zona sic është parashikuar dhe më lart, është plotësish një zonë industriale ku pothuajse mungojnë plotësish elementet faunistike dhe janë tepër minimalë elementet floristikë (në elementët e florës mund të përmenden vetem ato të realizuara nga vetë dorë e njeriut)

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Ne floren dhe faunen		
Shikaterrim i rendesishem habitateve natyrore		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne ne zonat e virgjera		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit		X
Percarje/izolim habitanteve te egra		X
Interferenca midis rrugeve natyrale te emigrimit te sisoreve		X

### **8.4.2.Habitatet (objekte me status të cilësuar)**

Parcela c zgjedhur per projektin në fjalë do të zhvillohet brenda karakterit të vet duke respektuar karakteristikat e zonës industriale.

### **8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve**

Siperfaqja që zhvillohet veprimtaria është një sipërfaqje e konsumuar me kohe pasi kemi të bëjmë me një objekt ekzistues të ish uzinës së tullave refraktare. Pra nuk kemi të bëjmë me toka bujqësore.Ushtrimi i aktivitetit në këtë zonë nuk ndikon negativisht në sasinë dhe cilësine e tokës.

### **8.5.1 Mbetje të ngurta**

Prodhimi i ferrokromit është i lidhur me gjenerimin e disa mbetjeve dhe hedhurinave që janë të listuara në Katalogun Shqiptar të Mbetjeve (i hartuar në përputhje me Katalogun Evropian të Mbetjeve). Mbetjet e ngurta më të rëndësishme janë skorjet e formuara në procesin e

shkrirjes, pluhurat e kapura në filtrin me mëngë, materialet e përdorur për veshjen zjarrduruvese të furrave dhe mbetjet e ndryshme nga ambalazhet.

### 8.5.2 Skorie metalurgjike të procesit

Në përputhje me përbajtjen e kromit në mineralin e përdorur, sasia e skories për 1 ton ferrokrom me karbon të prodhuar mund të variojë në vlerat  $1.3 \div 1.5$  ton skorie (sipas literaturës mund të gjenerohet nga  $1 \div 1.7$  ton/ton Fe-Cr). Përbërësit kryesorë të skories janë  $\text{MgO}$ ,  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  ( $3 \div 15\%$ ). Kimikisht skoria e furrës është shumë e qëndrueshme.

Nëpërmjet përpunimit te skorjeve me seperim magnetik, arrihet një shkallë rikuperimi kromi prej  $5 \div 6\%$  në masë. Pjesa tjetër e skories së mbetur trajtohet si mbetje dhe depozitohet në venddepozitimin e posaçëm. Në këtë vend depozitim do te depozitohen të gjitha skoriet e prodhua që nga fillimi i punës për herë të parë në këtë uzinë.

Në vende të tjera, për shkak edhe të karakteristikave të përshtatshme që zotëron, skoria e nga prodhimi i ferrokromit me karbon, pasi përpunohet (copëtohet), përdoret si material ndërtimi dhe material për shtrimin e rrugëve.

Sipas literaturës, sasia e skories që del gjatë prodhimit të ferrokromit me karbon është në vlerën 1.5 ton/ton. Përbërja kimike e kësaj skorie jepet në tabelën e mëposhtme.

Përbërësi	$\text{Cr}_2\text{O}_3$	$\text{Fe}_2\text{O}_3$	$\text{SiO}_2$	$\text{MgO}$	$\text{Al}_2\text{O}_3$	$\text{FeO}$	$\text{CaO}$
Përbajtja, %	$2.5 \div 6.5$	$0.5 \div 0.6$	$22 \div 33$	$9 \div 13$	$5 \div 9$	$0.6 \div 1.2$	$44.0 \div 45$

Kjo skorie zakonisht dërgohet në fushen e deopozitimit te mbetjeve

### 8.5.3. Mbetjet nga veshjet zjarrduruvese

Zakonisht përbëhen nga copa tulje zjarrduruvese dhe materiale lidhës që përdoren për veshjen e furrave të shkrirjes, furrave kovë, kovave të metalit dhe skories. Tullat që ruajnë akoma formë e përmasë ripërdoren, ndërsa të tjerat shkojnë për thyerje dhe bluarje duke u përdorur si shtesa e llaçit zjarrdurus.

### 8.5.4. Mbetje të elektrodave

Këto mbetje formohen në raste të rralla kur ndodhin këputje së elektrodave të vetëpjekura të furrave të shkrirjes. Janë copa në madhësi  $0.5 \div 0.75$  m, të cilat depozitohen, përkohësisht, në sheshin e depozitimit të lëndëve të para (ku depozitohet koksi metalurgjik). Pasi copëtohen në kokrra me madhësi, mbetjet e elektrodave ripërdoren në furrën e shkrirjes së ferrokromit si reduktues.

## **8.6 Impakt mbi Peizazhin**

Peisazhi nuk do tē dëmtohet nga ndërtimi i godines , pasi ajo do tē ndërtohet në harmoni me mjedisin rrëthues. Aktiviteti nuk paraqet ndonjë ndikim tē madh direkt apo indirekt në mjedis.

## **8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin**

### **8.7. 1 Ndikimet në zhurma dhe vibrimet**

Ushtrimi i këtij aktiviteti pa tjetër do tē shoqerohet dhe nga zhurmat e shkaktuara nga makinerite teknologjike si dhe ato tē transportit.

Zhurmat e cliruara do te janë brenda dhe normave dhe standardeve tē miratuara për ketë qëllim .

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritja e nivelit egzistue te zhurmave	X	
Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive	X	
Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit		X
Nivel me i larte i zhurmave per kafshet		X

Përsa i takon problemeve tē vibrimeve që lidhen me punën e makinerive tē rënda, ato do tē janë përsëri brenda normave janë tepër minimale dhe nuk merren në konsideratë.

### **8.7.2. Ndikimi në ajër**

Ushtrimi i këtij aktiviteti do tē këtë ndikim në cilësinë e ajrit tē zonës pasi gjatë shfrytezimit do tē ketë shkarkime tē gazrave dhe tē pluhurave pavaresisht se keto do tē janë brenda normave tē miratuara për këtë qëllim. Sidoqoftë subjekti ka marre shume masa në këtë aspekt dhe nga më kryesoret është ngritja e sistemit tē pluhur kapjes i cili influencon në mënyrë tepër pozitive në drejtim tē prevenimit e emetime tē gazrave dhe pluhurave.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne ajer	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit	X	
Ndotje nga djegia e hidrokarbureve	X	
Ndotje nga CO,SO2,NOx	X	

### 8.8 Impakt mbi trashëgiminë kultutore dhe arkeologjinë

Në zonën e shfrytëzuar, nuk janë parashikuar masa lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave arkeologjike apo historike, pasi nuk ka të tilla në të. Sic është theksuar dhe më sipër, aktiviteti i ushtruar është kombinuar dhe me funksionet e ndërhyrjeve inxhinjerike të objektit si shtrimin e shesheve të punës me beton, kanalizime, drenazhime, puseta për grumbullimin e ujравe atmosferike, kanalizim i ujравe të bardha e të zeza etj. Për pasojë është e domosdoshme që të ruhet sistemi i drenazhit të kjo gjë të cojë në evitim e ndryshimeve jo shumë të rëndësishme të sistemit të ujравe sipërfaqiore.

### 9. Anekset (harta)

- Plani i vendosjes së strukturës: "Leje ndërtimi për Uzinën e prodhimit të Ferrokromit, në Elbasan".
- Plani i Organizimit te Punimve
- Planimetria e zhvillimit në fazë të planit të përgjithshëm
- Plani i sisemimit të përgjithshëm
- Pamje 3 dimensionale të Uzines së Prodhimit të Ferrokromit

LEJE NDĚRTIMI PĚR UZINĚN E PRODHIMIT TĚ FERROKROMIT. NĚ EL BASAN

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KËSHILLIKOMBËTARI TE PËRBTUOR

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KRYETARI K.K.T  
MIKAI TOHEI

Z. EDIBAWA

卷之三

Memoranda

Minister i Finansien fra Industr

IEEE INSTITUTE OF ELECTRICAL AND ELECTRONIC ENGINEERS

PLANT VENTILATION & STRUCTURES

THE UNIVERSITY LIBRARY  
UNIVERSITY OF TORONTO LIBRARY SYSTEM  
KIRKLAND LIBRARY  
150 BLOOR ST. W.  
TORONTO, ONTARIO M5S 1E4  
CANADA  
TEL: 416-977-7000  
FAX: 416-977-7010  
E-MAIL: [kirkland@utoronto.ca](mailto:kirkland@utoronto.ca)


COOLING SYSTEM  
- COOLING SYSTEM  
- COOLING SYSTEM  
- COOLING SYSTEM

卷之三


PRECISION KADASTRAL SITE 1:2500

PROPERTY OF STATE

SILKLINE | 130



100



PRECISION KADASTRAL SITE 1:2500

## MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T SË SHQIPËRISË

Z. EDI RAMA

Vendimi Nr. .... Date: .....

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIËS

Z. DAMIAN GJIKNURI

Vendimi Nr. .... Date: .....

**OBJEKTI: UZINA E PRODHIMIT TE FERROKROMIT,  
NE TERRITORIN E "REFRAKTARE" SHA,  
FSHATI BALLDREN, KOMUNA PAPER, ELBASAN,  
ME INVESTITOR GSA SH.P.K., TIRANE**

"TE DHENA NBI PROJEKTI"

UZINA E PRODHIMIT TE FERROKROMIT  
\*GSA \*Aqek  
FSHATI BALLDREN-KOMUNA PAPER-ELBASAN

CLIENT: .....  
INVESTITOR: .....  
VENDODHJA: .....

GRUPI PROJEKTI:

Institut mekhanik  
Sipërshtetja  
Architect S.P. "Refraktar",  
P.R. TIRANA, ALBANIJA  
Mobile: +355 42 55 265  
Fax: +355 42 55 267


Institut mekhanik  
Dritan Mora  
Adresë: Rruga e Dites,  
Nr. 302, TIRANA, ALBANIJA  
e-mail: dritanmora@qym.com  
Mobile: +355 69 46 36 02/ 09 30 7796

EMERTIMI OBETITI  
G 01 - G 02 - G 03 - G 04 - G 05  
- G 06 - G 07 - G 08 - G 10

PLR, 2011

Revisi:


17/0



# MIRATOHET

ZHVILLIMI NE FAZAI I PLANTIT TE PERGJITHSHEM

SH 1:750



KRYETARI I K.K.T SË SHQIPËRISË  
2. EDI RAMA

Vendimi Nr. .... Data: ....

Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTRIA E ENERGIJISË DHE INDUSTRIËS

Vendimi Nr. .... Data: ....

Z. DAMIAN GJIKNURI

OBJEKTI: UZINA E PRODHIMIT TE FERROKROMIT,  
NE TERRITORIN E "REFRAKTARE" S.H.A.,  
FSHATI BALDREN, KOMUNA PAPER, ELBASAN,  
ME INVESTITOR GSA SH.P.K., TIRANE

TE DRIENA MEI PROJEKTIN

OLIDENT:	UZINA E PRODHIMIT TE FERROKROMIT
INVESTITOR:	* GSA - Shpk
VENDODHAJA:	FSHATI BALDREN- KOMUNA PAPER- ELBASAN

GRUPI PROJEKTIT:

ADMIRE:	Indirekt mbrojtës
ADMIRE:	Sipërshtata
ADMIRE:	ADMIRE S.A.S Adresat: Rr "M. Z. John", Sh. 1, Ag. 2, TIRANA, ALBANIJA
TEL:	055 4 22 22 80/07 30/36
FAX:	055 4 24 30 94
WHL:	+355 42 59 95
MBL:	055 05 21 05 97

Indirekt mbrojtës	Indirekt mbrojtës
Direkte Mbora	Direkte Mbora
Nr. 05 05 21 05 97	Nr. 05 05 21 05 97
Adresat: Rr "M. Z. John", Sh. 1, Ag. 2, TIRANA, ALBANIJA	Adresat: Rr "M. Z. John", Sh. 1, Ag. 2, TIRANA, ALBANIJA
WHL: +355 42 59 95	WHL: +355 42 59 95
MBL: 055 05 21 05 97	MBL: 055 05 21 05 97

EMERJINI I REZUELEVE:  
ZHVILLIMI NE FAZAI I PLANTIT  
TE PERGJITHSHEM

DATA: ....

Nr. Mbora: A - 02

PRIREDJE:

SHALLA

# MIRATOHET

PLANimetria e SISTEMIT TE PERGJITHSHEM

SH 1:750

KRYETARI I K.K.T SË SHQIPÉRISË

Z. EDI RAMA

Vendimi Nr..... Datë.....

MINISTRIA E ENERGIJËS DHE INDUSTRIËS

Z. DAMIAN GJIKNURI

Vendimi Nr..... Datë.....

**OBJEKTI: UZINA E PRODHIMIT TE FERROKROMIT,  
NE TERRITORIN E "REFRAKTARE" SH.A.,  
FSHATI BALLDREN, KOMUNA PAPER, ELBASAN,  
ME INVESTITOR GSA SH.P.K., TIRANE**

TE DIENËA MBI PROJEKTIN:

GRUPI PROJEKTIT:

GRUPI PROJEKTIT:

Adresat: Spiti DITTA  
Adresë: Rr. "Tirana", Nr. 100, Zona "Tirana",  
Fsh. Llogara, Elbasan, Shqipëri  
Nr. tel: +355 69 21 05 30  
Nr. fax: +355 69 21 05 30

Indrikim: Dritarja e Ministrit  
Dritarja e Ministrit  
Adresat: Dritarja e Ministrit  
Adresë: Rr. "Tirana", Nr. 100, Zona "Tirana",  
Fsh. Llogara, Elbasan, Shqipëri  
Nr. tel: +355 69 21 05 30  
Nr. fax: +355 69 21 05 30

EMETIMI/ OBLIGETI  
**G 01 - G 02 - G 03 - G 04 - G 05  
- G 06 - G 07 - G 08 - G 10**

DATA

Nr. Ref: A - 03

Revisi: 00

